Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/400
Datë 06.11.2015

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4, 7, 10, 11, 16 dhe 17, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 06.11.2015 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për riakreditimin dhe rivalidimin e Qendrës Social Edukative "Don Bosko", në Prishtinë për periudhën 06.11.2015 deri 06.11.2016 për të ofruar:

1.1 Instalues Elektrik, niveli III sipas KKK.

Riakreditimi dhe rivalidimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Në shumicën e rasteve, komunikimi i zyrtarëve të QSE me organizata dhe persona të ndryshëm realizohet përmes postes elektronike private. Rekomandohet që stafi menaxhues dhe i tërë stafi të pajisen me e-postë të QSE-së dhe komunikimi të kryhet përmes e-postave zyrtare.
- Përkundër faktit që kandidatëve u ofrohet edukim profesional në fushën e teknologjisë së informacionit megjithatë mungon zinxhiri i komunikimit që nga momenti që kandidati largohet nga qendra. Rekomandohet që të shtohet ky komunikim me qellim të marrjes se informatave kthyese dhe të vazhdohet kontakti me kandidatin deri në akomodimin e plotë të tij/saj.
- Në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit dhe në bazë të bisedave me menaxhmentin del se deri me tani nuk kanë pasur raste për njohjen e kredive, prandaj edhe nuk kanë zhvilluar procedurë për njohjen e kredive/moduleve. Rekomandohet që në bashkëpunim me AKK dhe MASHT të zhvillohet procedura për njohjen e kredive.
- Rekomandohet që dokumentacioni elektronik i qendrës të ruhet jashtë ambientit të qendrës së paku një herë në muaj në mënyrë që të evitohen humbjet shumëvjeçare të të dhënave elektronike në rast të ndonjë fatkeqësie në objektin e qendrës.

- Nëse kandidati nuk e kalon testin final, atëherë nuk dihet cila është procedura për mundësinë e ri testimit. Rekomandohet që të ketë procedurë të shkruar për mënyrën e ri testimit.
- Rekomandohet qendra që të caktojë një përgjegjës i cili do të kujdesej dhe do të njoftonte menaxhmentin për afatet e skadimit për pajisjet apo shërbimet me afat, siç janë aparatet kundër zjarrit, licencat e aplikacioneve të përdoruara, kutia e ndihmës së parë etj.
- Përkundër që ka politika të zhvilluara për zhvillimin dhe avancimin e stafit, një gjë e tillë nuk ka ndodhur që nga akreditimi i fundit, ku trajneri i profilit Instalues Elektrik nuk ka përfituar ndonjë trajnim i cili do të kontribuonte për rritjen dhe përditësimin e njohurive të tij. Rekomandohet që trajneri të përditësojë njohuritë e tij duke ndjekur trajnime dhe seminare që lidhen me fushën e tij.
- Sipas menaxhmentit deri me tani nuk ka pasur ndonjë rast të incidentit apo aksidentit, por rekomandohet që të ketë procedurë të shkruar për trajtimin e këtyre situatave.
- Dorezat aktuale në kabinetin e instalimeve elektrike nuk janë adekuate. Rekomandohet që kabineti të pajiset me doreza adekuate të cilat kontribuojnë në sigurinë e kandidatëve.
- Në kabinetin për instalime elektrike, njëra kuti e ndihmës së parë ishte e zbrazur, ndërsa kutia tjetër ishte e mbyllur me çelës dhe shihej se edhe ajo ishte e zbrazur. Rekomandohet që ndihma e parë të jetë e pajisur me fashat dhe medikamentet e domosdoshme dhe të jetë e hapur në çdo kohë.
- Rekomandohet menaxhmenti i qendrës të hartojë një plan veprimi të qartë për realizimin e të gjitha rekomandimeve të cekura me lart përfshirë objektivat,
  aktivitetet, personelin e dedikuar dhe afatet kohore për realizimin e tyre. Ky rekomandim ka dalë si pasojë që qendra nuk i ka përmbushur rekomandimet e kaluara me përpikëri.

(Afati kohor i këtyre kushteve: 01.06.2016)

1.2 Teknologji Informative dhe të Komunikimit, niveli II i KKK

Riakreditimi dhe rivalidimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Dëshmi e dokumentuar për programin EIPASS;
- Për secilin modul të caktohet numri i saktë i orëve dhe i kredive;
- Zhvillimi i bibliotekës digjitale;
- Hartimi i planit për zhvillim profesional të stafit;
- Vizualizimi i shenjave orientuese;
- Standardizimi i mënyrës së komunikimit formal të personelit;
- Vendosja e kutisë së ankesave/falënderimeve;
- Angazhimi dhe certifikimi i një nëpunës tjetër në cilësinë e ekzaminerit në Programin EIPASS;
- Zhvillimi i një bazë elektronike për ruajtjen e të dhënave ;
- Azhurnimi i përmbajtjes së të dhënave të ndjeshme në certifikatë;
- Komunikim më të shpeshtë me bizneset dhe Qendrën Rajonale të Punësimit.

(Afati kohor i këtyre kushteve: 01.06.2016)

1.3 Saldim, niveli III sipas KKK

Riakreditimi dhe rivalidimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Hartimi i politikave dhe procedurave te sistemit për sigurimin e cilësisë, përfshirë dokumentacionin dhe mekanizmat përkatës, si dhe proceset e punës.
- Trajnimi dhe Certifikimi i Trajnerit si në pjesën profesionale (në të gjitha proceset e Saldimit) po ashtu edhe në pjesën metodologjike.
- Hartimi i testeve për të gjitha nivelet e vlerësimit të kandidatëve (testi formativ dhe testi përfundimtar)
- Hartimi i planit vjetor për vlerësim dhe verifikim të brendshëm
- Të bëhet vlerësimi dhe verifikimi i brendshëm i sistemit të cilësisë dhe atë në faza të ndryshme të implementimit të kualifikimit.
- Zhvillimi i formularit për vlerësimit të performances së stafit.
- Të bëhet zhvendosja e furnizimit me acetilenit përmes sistemit qendror
- Të bëhet ridizajnimi i formularëve për monitorimin e procesit të mësimdhënies.

(Afati kohor i këtyre kushteve: 01.06.2016)

1.4 Instalues i Ngrohjes Qendrore, niveli III sipas KKK

Riakreditimi dhe rivalidimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Të krijohet një formë - test mbi vlerësimin e njohurive paraprake, paraqitja e qartë e kritereve për pranim të kandidatëve.
- Dëshmitë mbi analizën e tregut për profilin e "Instalues i Ngrohjes Qendrore" për te përcjell risitë ne fushe dhe kërkesat e tregut.
  Të zhvillohet lista me nënshkrim te kandidateve prezent, për secilën seance trajnimi.

(Afati kohor i këtyre kushteve: 01.06.2016)

1.5. Instalues i Ujësjellësit dhe Kanalizimit, niveli III sipas KKK

Riakreditimi dhe rivalidimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Të krijohet një formë - test mbi vlerësimin e njohurive paraprake, paraqitja e qartë e kritereve për pranim të kandidatëve.
- Dëshmitë mbi analizën e tregut për profilin e "Instalues i Ujësjellësit dhe Kanalizimit" për te përcjell risitë ne fushe dhe kërkesat e tregut.
- Të zhvillohet lista me nënshkrim te kandidateve prezent, për secilën seance trajnimi.

(Afati kohor i këtyre kushteve: 01.06.2016)

1.6. Asistent Administrativ, niveli III sipas KKK

Riakreditimi dhe rivalidimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Të standardizohen testet konform shkallës së kalueshmërisë dhe konform materialit të ri;
- Në kuadër të moduleve, të përshihet edhe moduli hyrje në marketing dhe trendet digjitale.

(Afati kohor i këtyre kushteve: 01.06.2016)

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

- Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit;
- Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
- Raporti i Vetë-vlerësimit;
- Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1 Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi i dërgohet:

- Qendrës Social Edukative "Don Bosko";
- AKK.

Nën- Kryetari i KD së AKK-së
Anton Gojani